



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr.104/02-21010
Kaçanik, 03.09.2021

PROCESVERBAL I DËGJIMIT PUBLIK- me të rinjët nga komuna jonë

11.08.2021

Vendi: Salla e Kuvendit Komunal

ora 14.00

Takimin e hapë z. Bahri Selimi, i cili përshëndet te pranishmit dhe shpjegon procedurat ligjore dhe arsyet kryesore te këtij takimi. Nder tjerash shpjegon kategoritë buxhetore ne shumata te ndryshme. Njofton se është bere lista e projekteve e cila nuk është definitive. I kalon fjalën Kryetarit te Komunës z. Besim Ilazi.

Kryetari Besim Ilazi:

Përshëndetje për te gjithë, me lejoni qe te ju falënderoj për pjesëmarrjen ne ketë takim. Ju njoftoj se jemi ne një faze te cilën e kërkon ligji te përgatitemi qe te hartojmë projekt buxhetin për vitin 2022. Të rinjët janë një resurs kombëtar, dhe edhe për komunën tonë kanë një vlerë të madhe, andaj ju ftoj që edhe në këtë debat të jeni një zë i fuqishëm, i arsyeshëm, të tregoni vërejtjet, brengat dhe sygjerimet tuaja. Sot fjala është e juaja. E hapi debatin

- 1- Enis Mjaki: Me hartu një plan afatgjatë për një hapësirë të përshtatshme për reliefin tonë, një hapësirë që do ti dedikohet festivaleve dhe aktiviteteve të tjera rinore e kulturore, si organizimi i ndonjë festivali etj.
- 2- Salla sportive, të intervenohet sa më shpejtë që kjo sallë të jetë e gatshme për të rinjtë, a keni pasur kontakte me deputetin nga komuna jonë për këtë çështje?
- 3- Flakron Tusha: Bursat një ndarje e mirë dhe korrekte, por kërkohet me e shtu si kusht që nga bursat të përfitojnë vetëm studentët që kanë kryer shkollën e mesme nga komuna jonë, me përjashtim të drejtimeve deficitare në komunë. Pse ende nuk është funksionalizu aneksi në Shkollën Profesionale. Të matet niveli i zhurmës gjatë orëve të natës.
- 4- Qendrim Qallaku: Të rinovohet Biblioteka e qytetit dhe salla e leximit tek Shtëpia e Kulturës. Të rinovohen dy hapësira ende të pa përfunduara tek shkolla në Dushkajë. Minibusi për sportistë dhe aktivitete të tjera është nevojë emergjente dhe si i tillë të kalojë për implementim nga viti 2023 në 2022.
- 5- Flaka Krivanjeva: Të zgjidhet problemi tek hapësirat e fabrikës, një zonë e braktisur dhe pamje e shëmtuar për komunën tonë, dhe pse duhet të ju votojmë juve si kryetar?
- 6- Vlora Krivanjeva: Të rriten kapacitetet e punëtorëve teknik në shkolla si dhe të vendoset roje në hyrje të shkollave, sidomos tek shkollat më të mëdha.

Për të gjitha kërkesat dhe shqetësimet e tyre u dhanë edhe përgjigje nga Kryetari Besim Ilazi dhe stafi i tij, ndërsa përgjigjet me shkrim janë paraqitur edhe në raportin e debeatëve publike.

Procesmbajtëse

Fatlume Guri Selimi





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr.104/02-21010
Kaçanik, 09.03.2021

PROCESVERBAL I DËGJIMIT PUBLIK- me gratë nga Komuna e Kaçanikut

06.08.2021

Vendi: Salla e Kuvendit Komunal
ora 14.00.

Takimin e hapë z. Bahri Selimi, i cili përshëndet te pranishmit dhe shpjegon procedurat ligjore dhe arsyet kryesore te këtij takimi. Nder tjerash shpjegon kategoritë buxhetore ne shuma te ndryshme. Njoftoi se është bere lista e projekteve e cila nuk është definitive. Nënkrjetari Ylber Bajra:

Përshëndetje për te gjithë, me lejoni qe te ju falënderoj për pjesëmarrjen ne ketë takim. Ju njoftoj se jemi ne një faze te cilën e kërkon ligji te përgatitemi qe te hartojmë projekt buxhetin për vitin 2022. Ju ftoj që të kontribuoni në këtë debat, i cili do të ju mundësoj të paraqitni shqetësimet dhe kërkesat tuaja.

Zarije Malsiu: Kërkoj që subvencionet të ndahen mirë, të ndahen për të gjitha gratë punëtore, të cilat punojnë fermat dhe bashqet e tyre. Këtu afër kam një grua të zonja nga Doganajt, e cila është shembull se si punohet, një fermere e cila premtion shumë, shpresojmë shumë që gra të tilla të përkrahen dhe të gjejnë mbështetjen nga institucionet lokale dhe qendrore.

Fatmir Loku- Drejtor për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, inkurajoi gratë që të jenë pjesëmarrëse në thirrjet për ndarje të subvencioneve, të cilat do të trajtohen barabartë dhe do të kenë mundësitë e njëjta për përkrahje, ndërsa gratë të tilla punëtore meritojnë përkrahje nga institucionet.

Për shkak të pjesëmarrjes së vogël të grave, takimi përfundoi me pak kërkesa .

Procesmbajtëse
Fatlume Guri Selimi





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr.104/02-21010
Kaçanik, 03.09.2021

PROCESVERBAL I DËGJIMIT PUBLIK- DUBRAVË
09.08.2021

Vendi: Shkolla Filllore " Kadri Zeka"
ora 20.00, Pjesëmarrës: 40.

Takimin e hapë z. Bahri Selimi, i cili përshëndet te pranishmit dhe shpjegon procedurat ligjore dhe arsyet kryesore te këtij takimi. Nder tjerash shpjegon kategoritë buxhetore ne shumata te ndryshme. Njofton se është bere lista e projekteve e cila nuk është definitive. Ia kalon fjalën Kryetarit te Komunës z. Besim Ilazi.

Kryetari Besim Ilazi;

Përshëndetje për të gjithë, më lejoni që të ju falënderoj për pjesëmarrjen në këtë takim. Ju njoftoj se jemi në një fazë të cilën e kërkon ligji të përgatitemi që te hartojmë projekt buxhetin per vitin 2022. Po e theksoj se sa i përket investimeve kapitale dhe shqetësimeve tjera te qytetareve te Kaçanikut e sidomos të Dubraves, gjithnjë e kam pasur derën hapur per ju dhe njëkohësisht e falënderoj z. Fadil Vishin qe gjithnjë i ka shprehur shqetësimet e juaja tek ne. Pervec investimeve te shumeta qe jemi munduar ti bëjmë shqetësuese per mua dhe juve mbetet problemet qe po na shkaktohen nga furnizimi me uje te pijes ne kete fshat. Problemi qe ka ardhur deri këtu eshte mungesa e stafit nga kompania "Bifurkacioni" e cila e ka te pamundur ta menaxhoj si duhet këto asetë. Kete problem e kam ngrite edhe me Ministrin z. Liburn Aliun. Megjithate, ju bej thirrje te gjithëve per shfrytëzim racional te ujit te pijes ne menyre qe mos te kete ngecje ne furnizim. Edhe nje here po ju them se punët kryesore ne fshatin Dubrave per sa i përket investimeve kapitale janë përfunduar apo presin te përfundohen edhe disa rrugica qe shpresojmë ti realizojmë shume shpejt.

Drejtori i DSHPE- Ramadush Osmani;

Pershendetje per te gjithë. Per dallim prej Kryetarit ju njoftoj se çështja e ujit te pijes ne Kosove eshte shume me i madh sesa duket ne te vertete, kjo si shkak se sipas eksperteve, Kosova gjendet ne zonat e rrezikuara me me se paku uje per koke te banorit. Përvec janë edhe problemet qe e karakterizojnë qeshtjen e ujësjellësit si psh sasia, procedurat, menaxhimi i punetoreve, keqpërdorimi etj. Ju njoftoj se ne si drejtori e DSHPE-se jemi marre shume me kete problematike dhe si opcion jemi ne kalkulim te kostos per ndërtimin e nje fabrike te ujit ne Sepetin.

Menduh Krasniqi;

Une shpreh shqetësimin se Lagjja Imishti nuk ka uje fare. Nuk janë kyqur ne sistemin e ri dhe ka shume probleme te kësaj natyre.

Drejtori i DSHPE- Ramadush Osmani;

Ky problem ne lagjen e juaj ka ndodhur si shkak interferimi mes dy sistemeve kete lagje e ka lene pa uje te pijes tash e nje kohe te gjate.

Zekirja Vishi;

Problemi qëndron sepse Vatajt nuk pranojnë me kaluar ne sistemin e ri te ujësjellësit.

Fadil Vishi- Kryetari i Keshillit te Fshatit Dubrave;

Drejtori eshte ne dijeni per problemin (debat i lire rreth kësaj teme)...

Bahri Selimi- Drejtor i DFZHE;

Po ju shpjegoj edhe nje here projekt listën per investimet kapitale. Eshte kodi i bashkëfinancimit, ndërtimi i trotuareve, rregullimi i sheshit te qytetit, ndërtimi i kanalizimeve dhe ujësjellësve, parqet publike, vendosja e parkingjeve, ndërtimi i shtigjeve per biçikleta etj. Po ua shpërndaj listën dhe ju lutem ta shikoni mire.

Fadil Vishi- Kryetari i Keshillit te Fshatit Dubrave;

Po e shpjegoj edhe njeher problemin e ujit me shpresën qe kjo qeshtje te rregullohet sa me shpejte. Une po propozoj qe ne projektet per vitin e ardhshëm te futet kodi per shtimin e fushës se shkollës me bari artificial. Gjithashtu kërkoj nga ju qe te keni parasysh intervenimin ne disa rrugica te fshatit per ti rregulluar ato. Si rrjedhoj e kërkesave te banoreve te kësaj ane, kërkoj qe te behet edhe investimi ne kanalin e ujitjes te tokave bujqesore.

Valmir Krasniqi;

Ju njoftoj se eshte shume e veshtire qe te behet menaxhimi i duhur i projekteve nga papërgjegjësia e operatoreve dhe kërkoj te rritet kjo përgjegjësi nga ta si dhe te caktohen mire prioritetet e projekteve.

Zahir Doda- Drejtor i DAKRS;

Pershendetje, nga bisedat ne kete takim pash tema qe u nderlidhen edhe me shkollën fillore. Po ju njoftoj se DAKRS ka caktuar prioritetet e saj ku pikërisht shkollën tuaj e ka futur ne prioritet duke i investuar me 50.000 euro ndërtimin e sallës se edukatës fizike dhe vitin tjetër pastaj do te merremi me kulmin, fasadën, izolimin etj.

Enver Kamishi;

A ka mundësi te caktohet nje ekspert lidhur me mundësinë qe te zhvendoset kaldaja e shkollës ne menyre qe ti lirohet hapësire ndërtimit te sallës se edukatës fizike (debat i lire rreth kësaj teme)...

Tefik Vishi- Drejtor i shkollës;

Pershendetje te gjithë, besoj qe te gjithë e dijme se tash e tutje po futemi ne nje faze te re te zgjedhjeve dhe ju bej thirrje qe te kemi kujdes ne kete drejtim. Shqetesimi per fshatin Dubrave besoj e pame te gjithë- uji. Gjithashtu shpreh keqardhjen per shkatërrimin ne mase te pyjeve ne parkun nacional dhe besoj qe pikërisht ky dëmtim i pyjeve ndikon ne mase te madhe ne mungese te ujit te pijes. Pe nisi me ankesa por mendoj qe menaxhimi i projekteve sidomos ne shkollën tone le shume per te dëshiruar dhe nuk jam aspak i kënaqur. Une jam drejtor shkolle dhe per punët qe behen ne shkolle shpeshherë anashkalohem nga menaxheri dhe firma kontraktuese.

Kryetari Besim Ilazi;

I nderuar drejtor, pajtohem plotësisht dhe i mirëkuptoj shqetësimet tua lidhur me qeshtjet te cilat i ngrite. Po te njoftoj edhe njëherë se qeshtja e menaxhimit te parkut nacional nuk eshte ne kompetence te Komunes. Te menaxhimi i projekteve dhe kualiteti i punës ne përgjithësi le shume per te dëshiruar, por nuk kemi çte bëjmë kur e dimë fare mire se është Ligji i Prokurimit Publik ai qe i rregullon këto gjera. Gjithashtu shqetësohem lidhur me qasjen neglizhente qe ka niveli qendror lidhur me projektet dhe shqetësimet tona te përbashkëta qe kemi.

Egëziona Imeri Neziraj;

Pershendetje per te gjithë, po besoj qe tema mjaft te rëndësishme per te gjithë ne u diskutuan ne kete takim por dua te di konkretisht nga drejtori lidhur me përkrahjen dhe ndarjen buxhetore ne baza gjinore?

Bahri Selimi – Drejtor i DEFZH;

E nderuar, ne projekt propozimet per buxhet natyrisht qe merret parasysh edhe përkrahja e grave ne forma te ndryshme dhe besoj qe kërkesën tuaj do ta kemi parasysh edhe ne vazhdim. Gjithashtu te gjith pjesëmarrësit i falënderoj per kontributin e dhene ne kete dëgjim publik. Gjithashtu ju falënderoj per propozimet e dhëna dhe ju konfirmoj qe do ti shqyrtojmë ne menyre sa me te mire te gjitha këto çështje. Nese nuk ka dikush me tepër te shtoje, une ju uroj nje jave te mbare dhe mirupafshim ne takimet tjera.

Takimi u përmbyll ne ora 21.30.

Procesmbajtësi
Festim Neziraj





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr.104/02-21010
Kaçanik, 03.09.2021

PROCESVERBAL I DËGJIMIT PUBLIK ME QYTETARË

Vendi: Shtëpia e Kulturës- Kaçanik
13.08.2021 ora 14.00

Takimin e hapi Nënkrjetari Ylber Bajra, i cili i përshëndeti të pranishmit dhe i inkurajoi për debat, ndërsa ia kaloi menjëherë fjalën Drejtorit për Ekonomi, Financa dhe Buxhet Bahri Selimit, i cili njëherit përshëndet te pranishmit dhe shpjegoi procedurat ligjore dhe arsyet kryesore te këtij takimi. Ndër të tjera shpjegoi kategoritë buxhetore me shuma te ndryshme. Njoftoi se është bërë lista e projekteve e cila nuk është definitive. Drejtori Selimi tha se buxheti për vitin e ardhshëm është 9 milion 193 mijë euro, ndërsa tha se le të shërbejë ky takim për marrje të ideve dhe gjithpërfshirje të grupeve të interesit në buxhetin komunal .

Ndërsa nga qytetarët të cilët morën fjalën dhe ju bashkangjitën këtij debatit dhe paraqitën idetë e tyre ishin:

Kjani Sallahu:

- 1- Të investohet më shumë në fshatin Biqec
- 2- Ndrçimi publik në fshatin Biqec
- 3- Riparimi i rrjetit të ujësjellësit- në Biqec
- 4- Rregullimi i rrugës “ Abit Dullovi”
- 5- Asfaltimi i rrugës alternative në Biqec
- 6- Zgjerimi dhe asfaltimi i rrugës “ Fadil Bunjaku”

Emrush Lika:

- 7- Rregullimi i ujësjellësit në Shtrazë
- 8- Të ndalohet dëmtimi i parkut nacional nga prerësit ilegal
- 9- Aktivizimi i AMF-së në Shtrazë dhe rregullimi i fushës sportive në këtë fshat
- 10- Rregullimi i rrethojës në shkollën fillore në Shtrazë

Enis Mjaki:

- 11- Të realizohet një platformë afatgjate e turizmit, të ju jepet prioritet projekteve afatgjate.
- 12- Të investohet në qytet e jo vetëm nëpër fshatra
- 13- Të krijohet një hapësirë për aktivitete rinore e kulturore
- 14- Krijimi i një ekonomie pa kufi- të krijohet një platformë e marketingut online për produktet në bujqësi dhe blegtori

Fatmir Qaka:

- 15- Rregullimi i sallës së leximit, bibliotekës dhe digjitalizimi i saj
 - 16- Shesh për zhvillim të aktiviteteve dhe rregullimi i një ekрани të madh në këtë shesh
 - 17- Rregullimi i amfiteatrit në kala
 - 18- Të rregullohet infrastruktura rrugore deri tek Kulla e Hasanit
- Arjan Zharku:
- 19- Realizim i investimeve në rrugën “ Qamil Ilazi”

Muhamet Berisha:

A ka investime në rrugën “ Qamil Ilazi” pse në hapësirën apo pronën time smundem me investu?

Për të gjitha kërkesat u dhanë përgjigjet nga ana e ekzekutivit komunal, ndërsa për secilën kërkesë ju është dhënë edhe përgjigje me shkrim në raportin e dëgjimeve publike.

Procesmbajtëse:

Fatlume Guri Selimi

